



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK TË PARTISË
ALEANCA DEMOKRATIKE, (ASE) NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE
USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për këshillat bashkiak të partisë Aleanca Demokratike (ASE), në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 585 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Aleanca Demokratike (ASE) në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

VËREN

Partia Aleanca Demokratike, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë Kuçovë, Devoll, Këlcyrë, Pogradec, Tropojë, Maliq, Kukës si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, për këto bashki: Kuçovë, Devoll, Këlcyrë, Pogradec, Tropojë, Maliq, Kukës asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- a. Zyra e gjendjes gjyqësore me shkresat nr. V-1564/1 prot., datë 18.05.2019 dhe nr. V-1510/1 prot., datë 15.05.2019 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, për bashkitë Kuçovë, Devoll, Këlcyrë, Pogradec, Tropojë, Maliq, Kukës sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare.
- b. Zyra e gjendjes gjyqësore me shkresën me nr. V-1564/1 prot., datë 18.05.2019 dhe nr. V-1510/1 datë 15.05.2019 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak Kuçovë, Devoll, Këlcyrë, Pogradec, Tropojë, Maliq, Kukës sipas të cilës rezulton se :

- **Bashkia Maliq, Kosta Koro me nr. 03** rendor në bazë të vendimit më nr. 60 datë 02.02.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Vjedhje" e në bazë të nenit 134/2 K.P dhe nenit 406 K.Pr.P e dënon me një muaj burgim. Në bazë të nenit 63 K.P zëvendësohet dënnimi me 40 orë punë.
- **Bashkia Tropojë, Xhemile Oruçi me nr. 10** rendor në bazë të vendimit më nr. 177 datë 25.11.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Mashtrim me sigurime" parashikuar nga neni 145 K.P dhe dënohet me 3 muaj burgim.
Në aplikim të nenit 59 të K.P pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe i pandehuri vihet në provë për një periudhë prej 18 muaj.
Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.



Nr. 585 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, të Partisë Aleanca Demokratike (ASE) në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

- **Bashkia Tropojë, Erdilant Kuçana me nr. 07** rendor në bazë të vendimit më nr. 54 datë 22.09.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Organizim i llotarive të palejuara në bashkëpunim", neni 197-25 K.P dhe e dënon me 120.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406 K.Pr.P e dënon me 80.000 lekë gjobë. Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.
- **Bashkia Pogradec, Bledar Çollaku me nr. 11** rendor në bazë të vendimit më nr. 31 datë 10.06.2003 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Armbajtje pa leje" dhe në bazë të nenit 278/2, 48/ç K.P dhe 406 K.Pr.P e dënon me 66.700 lek. Deklarohet fajtor për veprën penale "Prishje e qetësisë publike" parashikuar nga neni 274, 48/ç, K.P dhe 406 K.Pr.P, duke e dënuar me 33.300 lekë. Në aplikim të nenit 55/3 K.P e dënon përfundimisht me 666.7000 lekë gjobë. Gjoha të ekzekutohet me marrje forme të prerë të këtij vendimi datë 23.06.2003. Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.
- **Bashkia Pogradec, Alban Topçi me nr. 09** rendor në bazë të vendimit më nr. 150-22 datë 02.03.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Shkatërrim të pronës me zjarr" parashikuar nga neni 151/1, K.P dhe 406 K.Pr.P, duke e dënuar me 100.000 lekë. Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.
- **Bashkia Kukës, Sabri Deliu** në bazë të vendimit më nr. 14 datë 28.02.2003 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka deklaruar fajtor për veprën penale "Kundërshtim i punonjësit të policisë" parashikuar nga neni 236/1 K.P dhe 406 K.Pr.P. Në bazë të nenit 55 K.P e dënon përfundimisht me 300.000 lekë gjobë. Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.
- **Bashkia Kukës, Besnik Kapaj** në bazë të vendimit më nr. 57 datë 218.02.2008 është deklaruar fajtor për veprën penale "Kanosje" parashikuar nga neni 84 K.P dhe në bazë të kësaj dispozite është dënuar me 50.000 lekë gjobë. Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumemërore për këshillin e Bashkisë Kuçovë, Devoll, Këlcyrë, Pogradec, Tropojë, Maliq, Kukës të Partisë Aleanca Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE:



Nr. 585 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak, të Partisë Aleanca Demokratike (ASE) në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Njoftimin e KZAZ-së përkatëse për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Kuçovë, Devoll, Këlcyrë, Pogradec, Tropojë, Maliq, Kukës të Partisë Aleanca Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr . 585 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Aleanca Demokratike (ASE) në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.